


Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Ministarstvo Sredine i Prostornog  
Planiranja-Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

<b>DATË/A:</b>	05.12.2016
<b>REFERENC-Ë:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Komuna Shtime
<b>CC:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së 
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Shqyrtimi i kërkesës nga Komuna e Shtimes për Taksat për Leje të Ndërtimit për vitin 2017 me Nr.Protokolli 5200/16 të datës 18.11.2016.

Të nderuar,

Bazuar në shkresën e datës 18.11.2016 me numër protokolli 5200/16, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore dhe tarifës për rritjen e densitet të infrastrukturës nga Komuna e Shtimes (tutje si: Komuna), MMPH ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën se bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksën Administrative të lejes ndërtimore në pajtim me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2012 për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës.

Taksa Administrative për Lëshimin e Lejes se ndërtimit e llogaritur nga Komuna është **1.45 €/m<sup>2</sup>** ( një euro e katërdhjetë e pesë centë për metër katror ).

Tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 3 te UA Nr.22/2012, dhe kjo Tarifë duhet të llogaritet vetëm për njësit e reja te banimit, konform formulës se përcaktuar ne nenin 10, paragrafi 1 i UA nr.22/2012.

Komuna duhet të procedoj për aprovim taksat për lëshimin e lejes se ndërtimit në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt.

Faqe 1 nga 1